



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM KUKËS

Nr. 816 prot.

Kukës, më 28.09.2023

Lënda: Dergim plan veprimi,

Këshillit të Lartë Gjyqësor

TIRANË

Bashkelidhur ju dërgojmë plan veprimi lidhur me raportin e auditit për periudhën e audituar dt.01.10.2019-31.12.2022,

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Zv / Kryetarë

Merita Karaj



PLAN VEPRIMI

| Numri i Rekom. | Rekomandimet | Renditja sipas nivelit | Referenca e paragrafit në raport | Reagimi i menaxhimit të subjektit të audituar | Afati i përcaktuar | Personat përgjegjës për realizimin e rekomandimeve |
|----------------|--|------------------------|----------------------------------|---|--------------------|--|
| 1 | Për garantimin e rregullit e të sigurisë dhe zhvillimin normal të aktivitetit në Gjykatë, Këshilli i Gjykatës në bashkëpunim me KLGJ-në, Ministrinë e Drejtësisë dhe Pushtetin Vendor, të vazhdojnë përpjekjet për gjetjen e një ambienti të përshtatshëm që të garantojë elementët e sigurisë dhe ambiente të mjaftueshme e të përshtatshme pune për trupën gjyqësore, punonjësit e gjykatës, arkivën, ofrimin e një shërbimi cilësor për publikun bazuar në standardet e kërkuara. Deri në zgjidhjen e këtij problemi, të merren masat e duhura për garantimin e sigurisë në gjykatë | I lartë | Fq 17-18 | Pranuar, Eshte derguar shkresa 3706/1 date 22.09.2023 nga KLGJ-ja Ministrise se Shendetisise dhe Ministrise se Drejtise, Eshte lidhur marveshja nr 4814/1 date 26.09.2023 ndermjet KLGJ-se dhe Prokurorisë se Pergjithshme, | Menjherë | Keshilli i Gjykares KLGJ Ministria e Drejtise dhe Pushtetit vendor |
| 2 | Struktura përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore, të marrë masa që të sistemohej, inventarizohen e arkivohen të gjitha dosjet për rekrutimet/pranimet dhe largimet/lirimin nga puna të punonjësve me të gjithë dokumentacionin e krijuar në ndjekjen e procedurave që nga njoftimet /kërkesat/testimet/ankesat/eti, deri në fillimin/mbarimin e marrdhënies së punës | I mesëm | Fq 25-26 | Pranuar | Menjherë | Kancelari Shefi I Sektorit te Burimeve Njerezore |
| 3 | Në kuadrin e ndryshimeve ligjore struktura përgjegjëse të marrë masa: - Duke sistemuar në listëpagesa nivelet e pagës bazë për klasë për të gjitha pozicionet e punonjësve mbështetës - Të marrë miratimet për shtesën për vëshitresi e dëmshteri në punë për kategoritë përfutuese, sipas përcaktimeve të akteve ligjore në fuqi. | I mesëm | Fq 29-30 | Pranuar Eshte nisur shkresa nr.807,date 27.09.2023 per NJVKSH Kukes dhe me pas per te gjitha strukturat perkatese, | Deri 30.09.2023 | Zv.Kryetare e Gjykares Kancelari |
| 4 | Në qdo rast të rekrutimeve të reja nga struktura përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore, për shtesat e përhershme në pagë të merret miratimi në institucionet përkatëse, sipas përcaktimeve në aktet | I lartë | Fq 30-31 | Pranuar, Eshte nxjerre urdheri 108 date 31.08.2023 mbi | Menjherë | Zv.Kryetare E Gjykares |

Formati Standard 10:

| | | | | | | |
|---|---|---------|------------------------------|--|-----------|--|
| | <p>ligjore të përcillet në organin qendror, pas konfirmimit nga organi qendror dhe titullari i institucionit të reflektohet në urdhrin për pagesë duke u përcjellë në zyrën e financës për reflektim në pagë.</p> <p>Të ndërprerit shitesa e pages për kualifikim shkencor për punonjësën (R.K) të nxirret akti administrativ, të kryhet kontabilizimi dhe të bëhet ndalesa për përfitim të padrejtë duke kryer llogaritjet për gjithë periudhën që është përfunduar kjo pagë.</p> | | | <p>zhdentimin e shiteses se pages se perfutuar gabimisht dhe ka vazhduar ndalesa nga paga e KDB qe nga Muaji Gusht 2023,Shitesa e pages eshte nderprere qe nga data 01.06.2023</p> | | <p>Shefë e sektorit të buxhetit dhe finances</p> |
| 5 | <p>Këshilli i Gjykatës të analizojë situatën duke:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Nxjerrë përgjegjësitë për personat përgjegjës për situatën e krijuar, në lidhje me procesin e dorëzimit dhe marrjen e detyrës nga KDBuxhëtit. - Nëpunësi autorizues të ngrejë një grup pune për mbledhjen dhe sisteminin e dokumentacionit financiar për periudhën tetor 2019 - prill 2021, duke informuar Këshillin e Gjykatës me rezultatet në lidhje me situatën e dokumentacionit, në rast të konstatimit të mungesës së dokumentacionit të operohet sipas procedurave ligjore (i përket edhe sistemit të pagave dhe shpërblyeve) | I lartë | <p>Fq 27-28 Fq 38-39</p> | <p>Pranuar</p> | Menjêherë | <p>Keshilli I gjykares</p> |
| 6 | <p>Këshilli i gjykatës të marrë masa që avokatët e thirrur kryesisht në përfundim të çdo gjykimi(dhënia e vendimit) të pajisen me vërtetimin e përfundimit dhe përcaktimin e një afati të pranueshëm(brenda një muaji nga data e vendimit) për paraqitjen së faturës së shërbimit të kryer nga ana e tyre. Në faturat e paraqitura nga avokatët e thirrur kryesisht, të pasqyrohet numuri, data e vendimit të gjykatës dhe objekti i përfundimit i cili duhet të jetë i njëjtë me vërtetimin e lëshuar nga gjykata</p> | I Lartë | Fq 35-36 | <p>Pranuar,Eshte zbatuar rekomandimi lidhur me faturat e paraqitura te avokateve ku shenohet numeri dhe data e vendimit,</p> | Menjêherë | <p>Keshilli I Gjykares</p> |
| 7 | <p>Nëpunësi Autorizues të marrë masa për ndërprerjen e pagesës nga fondet buxhetore të shpenzimeve gjyqësore, për procese gjyqësore civile që paguhen nga palët dhe përpara marrjes së angazhimeve buxhetore dhe kryerjes së pagesave duhet të sigurohet se është kryer</p> | I Mesëm | Fq 36-37 | <p>Pranuar,Jane refuzuar faturat e paraqitura nga ASHK-ja dhe eshte bere e njohur qe keto fatura do te paguhen nga palët,</p> | Menjêherë | <p>Keshilli I Gjykares</p> |

Formati Standard 10:

| | | | | | | | |
|---|---|------------|----------|---------|-----------------------|----------------------------|--|
| | kontrolli që garanton ligshmërinë dhe rregullshmërinë e përdorimit të fondeve buxhetore | | | | | | Zv. Kryetare e Gjykatës Shefe e sektorit të Buxhetit dhe Finances |
| 8 | Akt-rakordimi i hartuar për gjendjen e detyrimit për pullat e taksës dhe nënshkruar nga gjykata ti dërgohet zyrtarisht me shkresë përcjellëse DRT Kukës dhe në rast të mos kthimit përgjigje ti drejtohet zyrtarisht Drejtorisë Përgjithshme të Tatimeve . | I mesëm | Fq 43-44 | Pranuar | Menjëherë | | |
| 9 | Nëpunësi Autorizues në ngritjen e komisionit të inventarizimit të aktiveve duhet të marrë në konsideratë parandalimin e konfliktit të interesit të antarëve të komisionit. Për aktivet e identifikuara pa çmim nga Nëpunësi Autorizues të merren masa për ngritjen e komisionit për caktimin e çmimeve dhe pas përfundimit të këtij procesi aktivet të bëhen hyrje dhe të merren në kontabilitet. | I mesëm | Fq 46-47 | Pranuar | Deri në 31.12.2023 | Zv. Kryetare e Gjykatës | |

Zv/Kryetare e Gjykatës
Merita KARAJ

